



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” Sh.P.K. të datës 19.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës Xhavit Ademi” me nr. të prokurimit 616-23-8865-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” Sh.P.K. e datës 19.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës Xhavit Ademi” me nr. të prokurimit 616-23-8865-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 19.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës Xhavit Ademi” me nr. të prokurimit 616-23-8865-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Në pjesën nr. 6 (Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues) të formularit F02 – Kërkesës për Rishqyrtim, parashtuesi ka shënuar si në vijim:

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Ne dok. të bera për konzorcium nga OE i shpërblyer me kontrate, kompania partnere në këto marrëveshje "Benita" shpk është përdorur nënshkrimi i personi i cili nuk është në marrëdhënie pune në këto kompani. Poashtu nënshkrimi i këtij personi është përdorur edhe në deklaratën nën betim dhe në marrëveshjen për furnizim me betone
2. Lista e pajisjeve ashtu si është kërkuar nga AK-s sipas FTD-se së dosjes së tenderit dmth Aneksi 8 nuk është plotësuar, është paraqitur një listë e përgjithshme e pajisjeve

Fillimisht duhet cekur se parashtuesi nuk e ka plotësuar në mënyrën e duhur formularin F02-Kërkesa për Rishqyrtim duke vepruar në kundërshtim me nenin 60 paragrafin 60.3 nënparagrafin d), f) g) dhe h) të RRPP ku është përcaktuar se kërkesa për rishqyrtim ndër të tjera duhet të përmbajë edhe elementet si në vijim:

- "d. bashkëngjitur një kopje të njoftimit të kontratës në fjalë ose njoftimit të rezultatit të konkursit për projektim, nëse një e tillë është nxjerrë apo publikuar;*
f. Përkthehen rrethanat faktike që përbejnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar;
g. Specifikon dispozitën apo dispozitat e LPP-së që pretendohet se janë shkelur; dhe
h. Përkthehen se si është shkaktuar shkelja e pretenduar, apo kërcënon të shkaktojë, dëm material parashtuesit të ankesës në rastet ku parashtuesi i ankesës përfshin një padi për kompensim".

Sidoqoftë, pretendimi i parë ankimor i parashtuesit është se në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është përdorur pa autorizim nënshkrimi i një personi të caktuar ku aludohet për inxhinierin Emin Demaku. Me qëllim të shqyrtimit të këtij pretendimi, Autoriteti Kontraktues ka kontaktuar me personin në fjalë (Emin Demaku) duke e njoftuar të njëjtin për pretendimin ankimor. Me këtë rast Emin Demaku me datë 22.12.2023 përmes emailit të tij personal ka dërguar te Autoriteti Kontraktues një deklaratë të nënshkruar prej tij ku thuhet se të gjitha dokumentet e tenderuesit të rekomanduar ku figuron nënshkrimi i tij, janë të nënshkruara personalisht prej tij përmes autorizimit dhe janë të dedikuara për aktivitetin e prokurimit për të cilin po bëhet fjalë. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë ankimor është i pabazuar në tërësi. Në vijim mund të shihet deklarata e Emin Demakut si në vijim:

Projekti:

NUMRI I PROKURIMIT: 616-23-8865-5-2-1

NUMRI I BRENDSHËM: 616 23 163 521

Titulli: „ Ndërtimi i rrugës Xhavit Ahmeti “

AK: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Për: Zyren e Prokurimit-KUVENDIN KOMUNAL PRISHTINË

Nga: z.Emin Demaku

Data: 22.12.2023

Lënda: DEKLARATË

(Për Projektin : Ndërtimi i rrugës Xhavit Ahmeti)


Pas analizimit të dokumentacionit dhe e mailleve , dhe si pasoje e ngarkesës në punë dhe si pasoje e procedurave të shumta tenderuese , ditë më parë nuk më është kujtuar që kam nënshkruar Konzoriumin dhe Deklaratat përcjellëse të Konzorciumit , gjithashtu edhe marrveshjen për furnizim me Beton me në emër të kompanisë Benita Comapny sh.p.k lidhur me kompaninë Flamuri V sh.p.k. me datë 20.11.2023 .

Unë Emin Demaku , pas rishikimit të kontakteve dhe emaileve para mbi një muaji konkretisht me 20.11.2023 , Deklaroj se kam nënshkruar në emër të kompanisë Benita Company sh.p.k. , ku jam edhe person i Autoirizuar për përfaqësim të saj.

Andaj përmes kësaj Deklarate , ju njoftoj se tërhiqem nga Deklarata paraprake e dates 19.12.2023 , dhe ju njoftoj se të gjitha deklaratat e tenderit në fjalë i kam nënshkruar vetë si person i autorizuar i kompanisë Benita Company sh.p.k.

Me respekt:

Emin Demaku



Sa i përket pretendimit të dytë ankimor se nuk është plotësuar aneksi 8 i dosjes së tenderit, duhet sqaruar se aneksi 8 është lista e pajisje të kërkuara sipas dosjes së tenderit. Me këtë rast tenderuesit nuk kanë pasur nevojë që të plotësojnë asgjë në këtë aneks por vetëm që të dërgojnë listën e pajisjeve të nënshkruar dhe vulosur siç është kërkuar me dosjen e tenderit. Nga administrimi me dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se i njëjti e ka dorëzuar listën e pajisjeve të nënshkruar dhe vulosur sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Prandaj pretendimi i dytë ankimor është gjetur se është pretendim i pabazuar në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.12.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.